

## VENDIM

Nr. 394, datë 27.6.2018

### **PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 440, DATË 17.5.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE, TË KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM PËR PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 33/1, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 440, datë 17.5.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në ndarjen I bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas shkronjës "ç", të pikës 5, shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:

d) "Të publikojë periodikisht informacionet e lidhura me aktivitetet e ofruesve të akredituar nga QKEV-ja. Këto informacione t'u jepen profesionistëve të shëndetësisë dhe strukturave e institucioneve shëndetësore, për të ndikuar në pjesëmarrjen sa më të gjerë të të interesuarve."

b) Pika 4, e ndarjes IV, ndryshohet si më poshtë vijon:

"4. Ofruesi duhet të ketë një përvojë të provueshme nga QKEV-ja ose nga institucione të tjera akredituese në një vend tjetër të BE-së ose OECD-së prej të paktën 1 (një) viti në fushën e edukimit në vazhdim në Shqipëri dhe me jo më pak se 50 aktivitete të akredituara në fushën e edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë."

c) Në fund të pikës 1, të ndarjes VI, shtohet fjalia me këtë përmbajtje: "Ofruesi i akredituar duhet të njoftojë QKEV-në 3 (tri) ditë pune përpara zhvillimit të aktivitetit për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të tij."

II. Ngarkohet QKEV-ja dhe të gjithë ofruesit e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Senida Mesi